



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

BULETINI

**I REFERATEVE TË KANDIDATËVE TË PARAQITUR NË
KONKURSIN NR. Nr. 01-21 TË DATËS 21.01.2016**

Fakulteti i Filologjisë

1. Referat për zgjedhjen e një (1) asistent për lëndët: Grup lëndësh në gramatikën e gjuhës angleze (Programi i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze)

1. Herolinda Bylykbashi

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
Fakulteti i Filologjisë, Prizren

 Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt 04.03.2016	
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	02-49




RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES
PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK

Fakulteti: i Filologjisë, Prizren
Lënda: Grup lëndësh në gramatikën e gjuhës angleze
(Programi i Gjuhës dhe i Letërsisë Angleze)
Kandidatja: Herolinda Bylykbashi

Të dhënat për kandidaten

Emri dhe mbiemri: Herolinda Bylykbashi
Datëlindja dhe vendlindja: 28.02.1992 në Suharekë, Kosovë
Gradat shkencore: Master i shkencave filologjike
Titujt akademik:
Viti kur është fituar titulli aktual:
Departamenti/Fakulteti:
Universiteti:

Komisioni recensues:

1. Kryetar Prof. ass. dr. Sermin Turtulla 
2. Anëtar Prof. ass. dr. Sejdi Sejdiu 
3. Anëtar Prof. asoc. dr. Shkëlqim Millaku 

Titulli akademik për të cilën shkruhet raporti:

Asistente

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

Fakulteti i Filologjisë, Prizren

Përvoja në mësimdhënie universitare

Kandidatja Herolinda Bylykbashi ka qenë e angazhuar si asistente në Fakultetin e Edukimit në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren prej muajit shkurt 2015 deri në muajin janar 2016, për lëndët e gjuhës dhe e letërsisë angleze. Kandidatja ka qenë e angazhuar në pesë programet e këtij Fakulteti, përfshirë atë të Gjuhës dhe të Letërsisë Angleze; të Gjuhës dhe të Letërsisë Shqipe; Fillor; Matematikë-Informatikë dhe Fizikë-Kimi. Kandidatja Herolinda Bylykbashi ka qenë e angazhuar si asistente nga tetori 2015-së deri janar 2016-së në lëndët e gjuhës dhe të letërsisë angleze në departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin "Ukshin Hoti" të Prizrenit.

Përgjegjësitë për aktivitetet në shërbim të njësisë akademike dhe udhëheqja në hulumtim

Kandidatja Herolinda Bylykbashi ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme akademike dhe në këtë rast ka fituar tri certifikata nga Universiteti Veror Ndërkombëtar i Prishtinës dhe një certifikatë nga 'TESOL Webinar'. Në kuadër të aktiviteteve të saja akademike përfshihet edhe një mirënjohje për kontribut të veçantë në Universitetin Veror Ndërkombëtar të Prishtinës.

Mobiliteti i kandidatës

Kandidatja Herolinda Bylykbashi i ka kryer studimet themelore në Universitetin e Prishtinës në departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze. Studimet pasuniversitare në të njëjtin Universitet dhe në të njëjtin departament i ka përfunduar me sukses të lartë.

Titulli i cili propozohet

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar të kandidatës, Komisioni recensues vlerëson se kandidatja Herolinda Bylykbashi i ka kryer studimet master në drejtimin përkatës, të cilat dëshmohen me diplomë; është nën moshën njëzet e tetë vjeçare

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

Fakulteti i Filologjisë, Prizren

kur emërohet për herë të parë, që dëshmohet me certifikatën e lindjes, dhe e ka notën mesatare në studimet themelore dhe në master mbi tetë që dëshmohet me diplomë. Komisioni recensues gjithashtu vlerëson se kandidatja në fjalë ka përvojë njëvjeçare në mësimdhënie universitare që dëshmohet me kontratat e punës. Kandidatja ka treguar përgjegjëshmëri dhe përkushtim në profesionin e saj që dëshmohet me referencën e dorëzuar në dokumentacion. Në bazë të këtyre dëshmive, Komisioni recensues vlerëson se kandidatja Herolinda Bylykbashi i plotëson kushtet e konkursit të shpallur për staf akademik me nr. ref. 01-21 të datës 21.01.2016 të Universitetit "Ukshin Hoti" të Prizrenit.

Duke u mbështetur në atë më lart dhe në Statutin e Universitetit "Ukshin Hoti" të Prizrenit, neni 174, Komisioni recensues ka nderin dhe kënaqësi t'i propozojë Këshillit të Fakultetit të Filologjisë, përkatësisht, Senatit të Universitetit "Ukshin Hoti" të Prizrenit, kandidaten Herolinda Bylykbashi ta zgjedh në thirrjen e asistentes për grupin e lëndëve në gramatikën e gjuhës angleze (Programi i Gjuhës dhe i Letërsisë Angleze).

Nënshkrimet e Komisionit recensues:

1. Kryetare Prof. ass. dr. Sermin Turtulla
2. Anëtar Prof. ass. dr. Sejdi Sejdiu
3. Anëtar Prof. asoc. dr. Shkëlqim Millaku

